



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 13.12.2021, ora 11.00

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisioni**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut mbi transferimin e personave të dënuar”.

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Greta Bardeli, Besion Ajazi, Blendi Klosi, Bardhyl Kollçaku, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Klodiana Spahiu, Lavdim Krrashi, Alqi Bllako, Tritan Shehu, Belind Këlliçi, Kreshnik Çollaku.

**Mungojnë:**

Benet Beci, Grida Duma, Vangjel Dule dhe Shpëtim Idrizi.

**Të ftuar:**

Adea Pirdeni - Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Politikës së Jashtme të datës 13.12.2021. Në rendin e ditës kemi diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut mbi transferimin e personave të dënuar”.

Të ftuar për diskutimin e këtij projektligjit kemi zonjën Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë.

Mirë se vjen, zonja Pirdemi!

Kemi gjithashtu të ftuar edhe zotin Beja, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Mirë se vjen, zoti Beja!

Jemi komision për dhënie mendimi. Fillojmë pa humbur kohë.

Fjala për zonjën zëvendësministre.

**Adea Pirdeni** – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Sot paraqitet për mendim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, mbi transferimin e personave të dënuar”.

Kjo marrëveshje synon të rrisë nivelin efektiv ndërkombëtar në fushën penale ndërmjet dy vendeve. Qëllimi i nënshkrimit të saj është të përmirësojë kushtet dhe rregullat për transferimin e personave të dënuar nga të dyja shtetet kontraktuese, në funksion të lehtësimit të riintegritit social të shtetasve të njërit shtet kontraktues, që vuajnë dënimin në shtetin tjetër.

Procedurat e transferimit të shtetasve të dënuar në Mbretërinë e Bashkuar kanë nisur në vitin 2013, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes për transferimin e të dënuarve ndërmjet dy vendeve dhe kjo marrëveshje ka rezultuar me një sërë problematikash në zbatim. Këto vështirësi kanë konsistuar kryesisht në kuptimin, në interpretimin dhe zbatimin e marrëveshjes nga gjykatat dhe prokuroritë vendase për shkak edhe të ndryshimit të sistemeve ligjore të drejtësisë mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, vend në të cilin bazohet sistemi homolog. Ndaj lindi si

domosdoshmëri përmirësimi i tekstit të marrëveshjes nga palët, duke i hapur rrugë kështu negocimit të një marrëveshjeje të re ndërmjet dy vendeve.

Kjo marrëveshje do të paraqitet për nënshkrim në vijim të një sërë tryezash rrumbullake të vendeve, të realizuara nga Ministria e Drejtësisë dhe institucione të tjera, të cilat përfshihen në procesin e transferimit, përfshirë këtu gjykatat dhe prokuroritë.

Kjo marrëveshje rregullon ato aspekte procedurale, të cilat kanë qenë pengesë për zbatueshmërinë e marrëveshjes, që është aktualisht në fuqi. Në marrëveshjen e re janë parashikuar në mënyrë të hollësishme procedurat që ndiqen nga të dyja shtetet kontraktuese për transferimin e personave të dënuar, vazhdimin e zbatimit të dënimit, si dhe të drejtat dhe trajtimi i personave të dënuar.

Më konkretisht, janë përmirësuar dispozitat që kanë të bëjnë me detyrimin për përkthimin e akteve, dokumentacionin e nevojshëm që shteti marrës kërkon, transferimin e personave të dënuar që duhet t'i japë shtetit transferues në kërkesën me shkrim për transferimin, si dhe informacionin e nevojshëm që kërkon shteti transferues nga shteti marrës, kur kërkon transferimin e personave të dënuar.

Gjithashtu, janë përmirësuar ndjeshëm parashikimet që adresojnë vazhdimin e ekzekutimit të dënimit nga shteti marrës, një nga aspektet më problematike të marrëveshjes ekzistuese.

Referuar parashikimeve të konventës, si dhe parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, si transferimi i shtetasve shqiptarë, që janë duke vuajtur dënimin në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe të Irlandës së Veriut, është i mundur vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte ligjore si më poshtë:

Së pari, duhet plotësuar kriteri i shtetësisë, që do të thotë se subjekt i transferimeve mund të jetë vetëm një shtetas shqiptar.

Së dyti, personi i dënuar duhet të japë pëlqimin për t'u transferuar ose është subjekt i një vendimi dëbimi, depërtimi apo largimi nga shteti transferues.

Së treti, duhet të respektohet patjetër parimi i reciprocitetit, që do të thotë se fakti penal do të jetë i dënueshëm nga legjislacioni shqiptar dhe ai britanik.

Vendimi i dënimit duhet të jetë i formës së prerë. Personit të dënuar i ka mbetur jo më pak se 6 muaj burgim për të vuajtur, çfarë nënkupton se pjesa e pavuajtur e dënimit nuk do të jetë më pak se 6 muaj.

E fundit, natyrisht, shtetet duhet të bien dakord për transferimin e personave të dënuar me jo më pak se 6 muaj.

Marrëveshja nuk parashikon kufizime në lidhje me llojin e veprave penale, për të cilat mund të kryhet transferimi.

Për sa u takon efekteve financiare, kjo marrëveshje nuk parashikon efekte shtesë në buxhetin e shtetit. Ne kemi bërë një përlllogaritje lidhur me efektet financiare që ka transferimi, duke marrë në konsideratë koston e transportit të një personi të dënuar dhe oficerit të policisë që do të duhet ta shoqërojë atë.

Së fundi, besojmë se kjo marrëveshje jo vetëm reflekton mësimet e nxjerra nga zbatimi i marrëveshjes ekzistuese, por rrit edhe efektshmërinë e zbatimit të marrëveshjeve dhe procedurave në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale.

Natyrisht, mbetemi në dispozicion për të diskutuar dhe qartësuar aspekte të veçanta të marrëveshjes, të cilat do të çmohen të nevojshme nga deputetët e këtij komisioni.

Ju faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Zëvendësministre!

Fjala për kolegun Koçi, si relator i këtij projektligji.

**Petro Koçi** – Faleminderit, kryetare!

Besoj se informacioni i domosdoshëm për komisionin u konsumua, megjithatë, dua të them se kjo është një marrëveshje në fushën penale mes dy vendeve, Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut.

Është një marrëveshje në fuqi e vitit 2013, por që ka identifikuar problematika në zbatimin e saj, ndaj edhe është përmirësuar. Me të drejtë ka pasur shumë takime dypalëshe për të ardhur në një tekst konsensual. Është një marrëveshje me shumë interes për shtetasit shqiptarë që jetojnë në Britaninë e Madhe dhe Irlandën e Veriut, por që fatkeqësisht kryejnë vepra penale, që janë dënuar atje dhe janë duke kryer dënimin.

Sigurisht, kjo lehtëson shumë gjëra në kuptimin njerëzor dhe i shërben një marrëdhënieje më të mirë me Britaninë e Madhe dhe Irlandën e Veriut, siç e kemi theksuar edhe në raste të tjera, që kemi të bëjmë me një vend partner, i cili është shumë i rëndësishëm për interesat tona të sigurisë, por sidomos në fushën e luftës ndaj krimit, madje, së fundi, duhet të përmend faktin që Britania e Madhe ka caktuar një përfaqësues për Ballkanin lidhur me politikën e këtij vendi ndaj një rajoni si yni, i cili vazhdon të ketë probleme.

Duhet të jemi të qartë, që, pavarësisht se është një marrëveshje dypalëshe, nuk besoj se në Shqipëri ka shtetas britanikë që vuajnë dënimin, ose mund të jenë raste tepër të rralla. Kjo është një marrëveshje që pikërisht në fokus dhe në zbatimin e saj ka të bëjë me shtetas shqiptarë që janë në Britaninë e Madhe dhe vuajnë dënimin atje për shkak të veprave penale.

Dua të theksoj se nga pikëpamja e juridiksionit ekskluziv mbetet gjithmonë shteti transferues, domethënë, në çdo rast, çdo rishikim i vendimit gjyqësor dhe dënimit i mbetet shtetit transferues e drejta ekskluzive e juridiksionit. Kjo është shumë e rëndësishme.

Kur bëhet fjalë për shtetas shqiptarë në Britani, bëhet fjalë për Britaninë e Madhe. Në material është edhe një tabelë lidhur me tabelën e përshtatjes së dënimit dhe kjo e bën të pamundur që të ketë abuzim nga autoritetet tona lidhur me mundësinë e rishikimit të dënimeve.

Gjithsesi, thashë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendoj, gjithsesi, se balanca ime është më realiste, por që...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë besoj se një nga arsyet që kjo marrëveshje është rishikuar, është edhe fakti që është ndërmarrë reforma në drejtësi dhe kredibiliteti i organeve tona të drejtësisë është rritur.

Kjo tabelë është një garanci më tepër lidhur me atë që shteti transferues duhet të ketë besim me vijueshmërinë e dënimit në shtetin marrës. Unë e ritheksoj, meqenëse do të ketë më shumë raste, do të ketë edhe më shumë transferime nga Britania në Shqipëri, sesa anasjelltas. Mendoj se kjo është një garanci për shtetin Britanik.

Gjithsesi, ftoj të gjithë anëtarët që ta kalojmë në mënyrë konsensuale dhe ta aprovojmë. Ne jemi komision për dhënie mendimi, pasi është Komisioni i Ligjeve ai që shqyrton më në detaje kushtetutshmërinë dhe përshtatjen e kësaj marrëveshjeje me legjislacionin tonë, por gjithsesi duhen thënë dy gjëra, e para, kjo është një marrëveshje që prevalon ndaj çdo marrëveshjeje tjetër që mund të jetë shumëpalëshe, dhe, e dyta, ashtu siç e ka edhe në Kushtetutë, prevalon shpesh edhe mbi përmbajtjen e ligjeve tona në këtë fushë.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Petro!

Ka pyetje dhe komente?

Fjala për zotin Kollçaku, pastaj zoti Shehu.

**Bardhyl Kollçaku** – Faleminderit, zonja kryetare!

E kam parë me vëmendje këtë ligj dhe kam disa pyetje për Ministrinë e Drejtësisë.

Pyetja e parë është: a keni dijeni sa është numri i përgjithshëm i shqiptarëve që vuajnë dënimin në Britaninë e Madhe dhe që përfitojnë ose janë subjekt i këtij ligji?

Pyetja e dytë: nga viti 2013 deri më sot sa shqiptarë kanë ardhur për ta vuajtur dënimin në Shqipëri në bazë të ligjit të vitit 2013?

Unë e dëgjova që ka pasur disa probleme, ndaj edhe po rishikojmë ndryshimet dhe klauzolat në ligj, që nuk është bërë i mundur ose është penguar që të sigurohemi që edhe mendimi i gjykatës, i prokurorisë, por edhe bisedimet që janë bërë që të mos vijmë sërish pas disa vitesh e të themi se na doli kjo apo ajo gjë tjetër që nuk janë ezauruar me këtë ligj dhe nuk po ecën si proces.

Ne kemi marrëveshje të tilla edhe me vende të tjera. A është ky ligj në përputhje, *mot a mot*, me Greqinë, Italinë ose me vende të tjera apo ka ndonjë specifike të veçantë?

Dua të sjell në vëmendjen tuaj një moment kur thuhet “me pëlqimin e atij që vuan dënimin”, ndërkohë thuhet “ose, nëse ka një vendim për dënim” apo diçka të tillë që vazhdon. Në qoftë se ai nuk është dakord dhe ka një vendim për dënim, a ka të drejtë ta çojë në apelim në Mbretërinë e Bashkuar, apo është në mënyrë direkte?

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zoti Kollçaku!

Para se t’ia jap fjalën kolegut Shehu, dua të bëj një vëzhgesë miqësore. Ligjet në përgjithësi nuk janë të dhëna njëherë e përgjithmonë, ndaj edhe ekzistojnë parlamentet, bëhen, por mund të ndryshohen, dhe çdo marrëveshje, qoftë kjo marrëveshje kuadër apo marrëveshje bilaterale, mund dhe duhet të ndryshojë edhe për faktin se ndryshojnë legjislacionet e vendeve respektive, ndryshojnë kushtet e të tjera. Pra, pse ky projektligj vjen pas disa vitesh dhe ndryshohet, shtohet apo hiqet diçka, ndaj jemi këtu ne. Kjo ishte sa për një precizim të asaj që tha gjenerali.

Zoti Shehu.

**Tritan Shehu** – Besoj se përfaqësuesit e ministrisë duhet t’u përgjigjen këtyre pyetjeve. Unë jam dakord me atë që thatë, madje mi keni marrë nga goja pyetjet.

Megjithatë, kam edhe unë pyetjet e mia. A keni një numër sa mund të jenë?

E dyta, si është kapaciteti i burgjeve tona, sepse, me sa di unë, situata është e rënduar? A shoqërohet kjo me një faturë financiare për të shtuar kapacitetet në Shqipëri për të burgosurit? Sa

është kjo faturë financiare? Në cilin buxhet është parashikuar? Kjo për të bërë të mundur që të burgosurit kudo që kryejnë dënimin, janë njerëz dhe duhet të jenë në kushte normale jetese dhe jo të mbingarkuar, siç janë shpesh burgjet tona, që thonë se janë në numra të papranueshëm në ambientet ku janë futur. Ata duhet të trajtohen me të gjithë respektin si qenie njerëzore, pavarësisht dënimit që kryejnë, pastaj, pasi kryejnë dënimin, janë njerëz si gjithë të tjerët dhe duhet të trajtohen me të gjitha parametrat. A ka një studim të qartë se sa është fatura financiare; sa është numri i të ekstraduarve që pritet të vijnë; si janë kapacitetet tona? Shpesh bëhen të tilla marrëveshje thjesht për të thënë se jemi kush jemi, i bëjmë qejfin njërit apo tjetrit partner dhe pastaj penalizojmë të burgosurit, që në finale janë njerëz.

Edhe unë jam i shqetësuar për atë që u tha, lidhur me dëshirën e atij që kërkohet të transferohet. Në qoftë se ai nuk do, çdo të thotë kjo me vendimin e ekspulsit? Mos bie ndesh me të drejtat e njeriut? Mua më tingëllon sikur bie ndesh me të drejtat e njeriut, sepse, në fund të fundit, është vullneti i tij i parë që duhet të prevalojë se ku do ai që ta kryejë dënimin, meqenëse e ka këtë mundësi. Unë nuk jam kundër që të marrim ata shqiptarë që duan të vijnë në Shqipëri, absolutisht, është humane kjo, por mund të jetë një pjesë që e kanë familjen atje në Britani apo në Irlandë dhe në këtë rast bëjmë të kundërtën. Pra, janë disa elemente që duhen parë, që lidhen edhe me të drejtat e njeriut, me kushtet e këtushme, kapacitetet tona, me faturën financiare që unë e dua të saktë, sa është, sepse kjo kërkon një mbulim në buxhet struktural dhe operativ.

Pra, duhet të shikojmë edhe interesat tona në këtë rast, se ata mund të kenë interes për t'i larguar dhe unë i kuptoj, sepse është ngarkesë financiare edhe për ta e shumëllojshme, sikurse edhe me ne do të ishte e njëjta gjë po të kishim të burgosur të huaj, pra prevalojnë disa elemente të tilla, që duhen sqaruar para se të gjykojmë se si do të votojmë.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Shehu!

Para se t'ua jap fjalën të ftuarve, më lejoni t'ju them se për të gjitha ato pyetje, për të cilat keni nevojë për të parë më në detaje të dhënat tuaja statistikore, buxhetore apo më shumë se kaq, kërkesat që bëhen në komision konsiderohen zyrtare, ndaj brenda një afati kohor-ligjor ju mund të përgatisni një material, të cilin duhet ta çoni pranë sekretariatit të komisionit, në mënyrë që pastaj të shpërndahet elektronikisht tek të gjithë anëtarët e komisionit.

Për çka mund të përgjigjeni, duhet të përgjigjeni. Fjala për ju, zëvendësministre.

**Adea Pirdeni** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, deputetëve, për pyetjet e shtruara!

Do të doja të bëja një parantezë në lidhje me përgjigjet e pyetjeve të deputetëve të nderuar. Që në fazat e para të diskutimit për rishikimin e një marrëveshjeje të re deri në fazën e negociimit me palën britanike dhe gjithashtu në fazën ku Ministria e Drejtësisë ka përgatitur të gjithë kuadrin ligjor për konsultimin me të gjitha institucionet e tjera të përfshira të Republikës së Shqipërisë, sigurisht që janë marrë në konsideratë standardet më të larta kushtetuese dhe konventore për zbatimin e të drejtave të trajtimit të personave të dënuar. Kjo do të thotë se ky është guri ynë i themelit në të gjithë këtë proces, pavarësisht nevojave ose interesave të paraqitura, si dhe interesave që kanë një pjesë e mirë e bashkatdhetarëve tanë që duhet të rikthehen në Republikën e Shqipërisë, mbahet patjetër parasysh respektimi dhe trajtimi i personave të dënuar mbi të gjitha.

Për t'iu rikthyer pyetjeve, lidhur me pyetjen e parë të zotit Kollçaku, në bazë të informacioneve që ne kemi, aktualisht vuajnë dënimin në Mbretërinë e Bashkuar dhe atë të Britanisë së Madhe të Irlandës së Veriut rreth 1500 shtetas shqiptarë. Ky është numri i shtetasve shqiptarë pak a shumë në vija të përgjithshme. Ne mund t'ua paraqesim edhe me shkrim këtë informacion, për të qenë më në detaje dhe për të mos e rumbullakosur shifrën.

Për sa i përket marrëveshjes së vitit 2013 dhe numrit të personave të transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje, numri është shumë i vogël edhe për shkak të faktit, që, sikurse e përmendëm, procedurat e kanë penguar avancimin e këtyre proceseve. Për shembull, një nga problematikat kryesore që janë krijuar ka të bëjë jo vetëm me çështjen e fakteve që një pjesë e procedurave në Shqipëri kryhej ekskluzivisht nga gjyqësori, ndërkohë që në Britaninë e Madhe kryhen edhe nga autoritetet administrative, që do të thotë se sistemet ligjore kanë qenë të ndryshme për të konsideruar se cili është organi i fundit vendimmarrës ose që duhet të vendosë në lidhje me transferimin.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë gjithashtu edhe në kuadër të asaj që përmendi relatori i çështjes, zoti Koçi, fakti që mënyra se si konvertohej dënimi në Republikën e Shqipërisë shpeshherë ka hasur problematika, do të thotë se mënyra se si është përshtatur në Republikën e Shqipërisë ka krijuar jo vetëm problematika në sistemin tonë ligjor, por edhe me partnerët tanë. Ndërkohë që këto çështje mendojmë se i ka zgjidhur në mënyrë përfundimtare neni 7 i marrëveshjes, i cili e saktëson në mënyrë të shprehur se personi, i cili do të vuajë dënimin, do të transferohet në shtetin marrës dhe shteti marrës zbaton dënimin sikur të ishte marrë në shtetin transferues. Do të thotë se, nëse kanë mbetur 3 vjet nga vuajtja e dënimit,



personi do të transferohet në Shqipëri dhe do të vuajë po kaq edhe këtu, natyrisht nëse vepra penale dënohet si në Shqipëri edhe në Britaninë e Bashkuar.

Pra, ky ka qenë kujdesi ynë i parë për ato elemente procedurale që janë rregulluar në mënyrë që të facilitohet transferimi edhe në vijim të asaj që sikurse e përmendi zoti Koçi, që interesi ynë është që t'u krijojmë mundësinë shtetasve tanë që të mund të vuajnë dënimin pranë familjarëve të tyre.

Për sa i përket çështjes së tretë që ju përmendët, që ka të bëjë me rastet e deportimit, në lidhje me këtë çështje parashikohet shprehimisht në marrëveshje që një person për të cilin janë duke u zhvilluar aktualisht procedime të tjera penale në vendin që do të transferohet, ky person nuk mund të jetë subjekt transferimi. Kjo do të thotë se ky person duhet të mbarojë çdo proces atje, dhe më pas, në përfundim të atij procesi, personi mund të transferohet duke pasur parasysh që në fund të procesit të vendimmarrjes edhe në lidhje me deportimin, nëse vendoset nga autoritet vendase që një person do të duhet të transferohet, ai person do të transferohet në Shqipëri, nëse patjetër të dyja palët mbajnë parasysh të gjitha kushtet e parashikuara nga marrëveshja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, sipas të gjitha procedurave që parashikon legjislacioni i vendit përkatës, i cili ka vendosur procesin e deportimit, që do të thotë se kjo marrëveshje nuk i heq asnjë lloj të drejte procedurale në asnjë lloj forme çdo shtetasi shqiptar që është në proces pranë autoriteteve britanike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rastin konkret, duke qenë se ka një vendim të formës së prerë për dënimin e personit, ka edhe një vendim deportimi, në këtë rast autoritetet shqiptare do të duhet të marrin në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes.

Në rastin konkret, personi mbas vendimi të deportimit mund të transferohet në Shqipëri nëse autoritetet shqiptare bien dakord.

Ideja është që transferimi është një proces, i cili kërkon vullnetin e të dy shteteve, do të thotë që nuk mund të realizohet vetëm nëse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E qartë. Ky është procesi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me raste deportimi.

Natyrisht shteti pritës, në rastin kur është Shqipëria, ka të drejtën të vlerësojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në rastin konkret, sipas marrëveshjes, shteti palë mund të vendosë që të vijojë ose jo me procesin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** – Urdhëroni, zonja Zëvendësministre!

**Adea Pirdeni**– Në vijim të pyetjeve të shtruara nga zoti Shehu, kapacitetet tona në sistemin penitenciar praktikisht vlerësohen në këta terma:

Aktualisht, kemi një kapacitet akomodues prej 5788 të burgosurish dhe vuajnë dënimin në Republikën e Shqipërisë, në institucionet e vuajtjes së dënimit, 5403 të burgosur. Në terma shifrash kemi aktualisht diku te 385 vende të lira, por, në bazë të një analize që ka bërë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si institucion varësie e Ministrisë së Drejtësisë, rezulton që një pjesë e këtyre vendeve janë të reduktuara në raport me këtë numër dhe ne vlerësojmë (në vlerësimin e fundit që është bërë muajin e shkuar) se kemi efektivisht 105 vende të lira në institucionet e vuajtjes së dënimit.

Kjo nuk do të thotë që këto 105 vende të lira janë të lira për personat të cilët mund të transferohen, absolutisht, por këto janë vende të lira, të cilat do të duhen të konsiderohen duke marrë në konsideratë një shumësi faktorësh:

E para, në bazë të analizave që ka bërë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në Shqipëri ka një trend rritjeje të numrit të personave që vuajnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit. Duhet të marrim parasysh se ne kemi marrëveshje transferimi edhe me vendet e tjera, pra janë një sërë shkaqesh dhe një sërë arsyesh të cilat merren në konsideratë në momentin që vlerësohet nëse sistemi penitenciar është në gjendje të përballojë transferimin e një personi të dënuar në Republikën e Shqipërisë.

Për sa i përket çështjes që ka të bëjë me koston, në vlerësim të analizës që kemi bërë ne, për sa i përket mënyrës se si do të bëhet transferimi i një personi dhe kostot që atashohen me transferimin, vlerësohet që për transferimin e një personi të dënuar në Republikën e Shqipërisë, kostoja e transferimit është 270 mijë lekë, ndërsa kostoja e transferimit të personit, i cili do të shoqërohet nga një punonjës i policisë është 108 lekë (po i referohen si fillim vetëm koston së transferimit).

*(Diskutime nga salla.)*

**Mimi Kodheli** – Ju lutem, zoti Shehi, mos ndërhyini!

Kostot e mbajtjes së një qytetari në Shqipëri, që vuan dënimin, janë rreth 500 euro në muaj dhe, nëse keni nevojë për një analizë se sa do të na kushtojë në vit mesatarisht mbajtja e atyre që janë të depërtuar, mund t'ua kërkojmë këtë analizë zotërinjve dhe të shikojmë se shtohen personat në penitenciarët tona dhe sa shtohen personat që vuajnë dënimin e heqjes së lirisë në këtë rast.

Nuk është se 1500 vetat e dënuar do të vijin nesër, kështu që kjo është një dinamikë e numrave të njerëzve të dënuar në penitenciarët tona.

**Adea Pirdeni** – Ne nuk thamë që nuk ka vende, por përmendëm se cilat janë shifrat aktuale dhe thamë që 105 vende janë aktualisht të lira dhe plotësojnë standardet, sepse kjo është më e rëndësishmja, se, nëse transferohen personat e dënuar, do të duhet t'i respektojmë të gjitha standardet të hapësirës së kryerjes së aktiviteteve, hapësirat sanitare dhe në çdo aspekt do të duhet të respektohen këto standarde, në mënyrë që ne të presim persona të dënuar.

Pra, këto janë kapacitetet që ne kemi; nuk do të thotë që nuk kemi vende, por vlerësimi i transferimit të një personi të dënuar në Republikën e Shqipërisë do të duhet të marrë në konsideratë një sërë rrethanash, të cilat do të vlerësohen në momentin kur do të bëhet transferimi në bazë të një analize të thelluar të sistemit penitenciar dhe gjendjes së tij në atë moment.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Zëvendësministre!

Përpara se t'ia jap fjalën zotit Krrashi, doja vetëm një sqarim. Supozojmë që një legjislacion të ndryshëm për të njëjtën vepër penale në dy vende të ndryshme, pra, po marr një shembull, përdhunimi mund të jetë i dënueshëm 15 vjet në Mbretërinë e Bashkuar dhe mund të jetë 10 vjet këtu. Në qoftë se i dënuari ka kryer 10 vjet dënim në Mbretërinë e Bashkuar dhe vjen në Republikën e Shqipërisë ku një legjislacion tjetër, bën dënimin e mbetur në bazë të legjislacionit të vendit nga ku vjen, a rivlerësohet dënimi i tij?

**Adea Pirdeni** – Ne kemi maksimum dënimi të parashikuar në legjislacionin shqiptar, që është 12 vjet dhe i dënuari do të kryejë vetëm pjesën e mbetur të dënimit, pra do të rikonsiderohet, do të konvertohet më pas dënimi.

Ne kemi parashikuar një tabelë që është inidkative për gjykatat se si do të duhet ta përshtatin dënimin, kur dënimi maksimal në Britani është më i madh se dënimi maksimal në Shqipëri.

**Mimi Kodhëni** – Pra, do të përshtatet, që do të thotë se, në qoftë se ka kryer 12 vjet dënim atje për të njëjtën vepër penale, këtu ripërshtatet, që do të thotë se konsiderohet i lirë, po flas për pjesën e mbetur të dënimit.

**Adea Pirdeni** – Është subjekt i vlerësimit të strukturave tona, e gjykatave, por nuk mund të jetë i lirë. Do të duhet të rivlerësohet, më pas do të bëhet konvertimi i dënimit.

**Mimi Kodhëli** – Logjika është të rivlerësohet me synimin që ta mbyllë dënimin, meqenëse ka kryer aq dënim sa do të kishte kryer sikur këtë vepër penale ta kishte kryer në Shqipëri. E qartë.

Urdhëroni, Lavdrim!

**Lavdrim Krrashi** –Desha të adresoj shumë shkurt çështjen e të drejtave të njeriut. Është treguar kujdes i veçantë, sidomos nga gjykatat britanike, por edhe nga negociuesit e marrëveshjes.

Në fakt, gjykatat britanike, në të njëjtën kohë që vendosin dënimin për krimin që dikush është gjetur fajtor nga gjykata, vendos për atë qytetar edhe çfarë do të ndodhë me të në kohën kur kryhet dënimi. Zakonisht, për të qenë praktikë për qytetarët të cilët janë pa dokumente, ose të parregullt, gjykata vendos që me mbarimin e dënimit, të bëjë edhe depërtimin e tyre, sepse ata nuk kanë leje qëndrimi, ndërkohë që për qytetarët e tjerë, të cilët janë të stabilizuar, kanë hedhur rrënjë, pra kanë familje, gjykata është shumë e kujdesshme për të zbatuar artikullin 8 për të drejtat e njeriut, të drejtën e familjes, i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Unë e di që Britania është larguar nga BE-ja, por krejt legjislacioni i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut është adoptuar në legjislacionin britanik, kështu që merret vendimi me shumë kujdes, duke pasur parasysh të drejtat e njeriut.

Unë mendoj që nga 1584, që është sot numri i saktë i të dënuarve shqiptarë në burgjet britanike, natyrshëm jo të gjithë do të jenë subjekt i riadhesimit ose i largimit drejt Shqipërisë, pikërisht për këtë arsye.

**Mimi Kodhëli** – E vlerësoj komentin e zotit Krrashi, qytetar i Mbretërisë së Bashkuar dhe i Republikës së Shqipërisë, gjithashtu.

Kolegu Koçi!

**Petro Koçi** – Kam një koment të shkurtër në lidhje me shqetësimin për kapacitetet në Republikën e Shqipërisë, por edhe nga këndi i interesit njerëzor, humanitar, siç e tha edhe zoti Krrashi, lidhur me rrethanat në të cilat ndodhet i dënuari në Britani kur ka familjen.

Ne harrojmë një gjë, një nga kushtet që të zbatohet marrëveshja është që të dyja palët duhet të bien dakord, që do të thotë se pala shqiptare nuk mund të pranojë përtej kapaciteteve që ka dhe, e dyta, nëse rrethanat e atij personi janë të tilla që ka familjen, për shembull, edhe sikur gjykata britanike “të ketë gabuar”, atëherë pala shqiptare nuk e merr parasysh...

*(Diskutime nga salla.)*

Pala shqiptare duhet të bjerë dakord për çdo person.

*(Diskutime nga salla.)*

Po flas për rastet kur i dënuari nuk jep pëlqimin. Por edhe kur i dënuari e jep pëlqimin, nëse nuk ke kapacitet, nuk e merr dot.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Koçi!

Kolegu Bllako.

**Alqi Bllako** – Faleminderit, kryetare!

Dëshiroj të bëj vetëm një sqarim për sa i përket pyetjes që u bë nga zoti Shehi në lidhje me efektet financiare, mendoj se një marrëveshje e tillë nuk ka efekte financiare të shtuara, pasi në logjikën e buxhetimit nga institucioni që në këtë rast është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, buxheti lidhet me kapacitetet akomoduese.

Pra, nëse kemi 1500 shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin në Britaninë e Madhe dhe janë potencialisht të transferueshëm në Shqipëri, mund të jenë edhe 2000 të dënuar në Itali dhe në Greqi, të cilët janë, po ashtu, potencialisht të transferueshëm në Shqipëri, buxheti nuk lidhet me numrin e këtyre personave, të cilët janë potencialisht të transferueshëm, por lidhet me kapacitetet akomoduese. Kur DPB-ja bën planifikimin vjetor të buxhetit, e bën mbi kapacitetin maksimal të vendeve për akomodim dhe në asnjë rast numri i transferimeve nuk mund të jetë përtej kapaciteteve akomoduese të një vendi. Pra, më shumë për sqarim, nuk ka efekte të shtuara financiare.

Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Çollaku!

**Kreshnik Çollaku** – Unë nuk kam ndonjë gjë kundër në parim me marrëveshjen. Patjetër që mendoj se është detyrim partneriteti dhe duhet mbështetur. E vetmja gjë që, realisht, më vjen rëndë dhe një lloj turpi, po e them fare hapur, që ne mblidhemi për të folur për këta njerëz vetëm në raste të tilla. Nuk bëhet fjalë për një grup, por bëhet fjalë për gjysmën e popullatës shqiptare që jeton jashtë kufijve dhe në parlamentarët apo institucionet e larta të shtetit mblidhemi për ta

vetëm kur duhet të akomodojmë situata të tilla depërtimesh, kapacitetesh apo të tjera me radhë. Sigurisht, ne këto duhet t'i bëjmë, por është absolutisht e papranueshme që ne këtë situatë që ndodhemi, me këto kapacitete, me këtë popull, me këtë Shqipëri të dytë që është andej, ne trajtojmë vetëm çështje deportimesh, asnjë politikë të shtetit shqiptar, të parlamentit, asnjë iniciativë për t'i asistuar edhe atje, në fund të fundit, këta njerëz. Nuk po ju krahasoj me shtete të fuqishme në diasporë, me aktivitetet karshi diasporave, Izrael, Turqia apo vendeve të tjera, por ta krahasojmë me Kosovën. Qeveria e Kosovës bën për emigracionin e vet shumë më shumë, është shumë më aktive, ka më shumë nisma se sa shteti shqiptar.

Po t'u referoheni vetëm disa muaj më parë nismave të qeverisë së Kosovës, Kryeministrit Albin Kurti, për diasporën, kishte dhjetëra nisma, në ekonomi, në korsi preferenciale për investime, në bonuse për kredi, në gjithçka.

Ne kemi ngelur te kjo rutina që diskutojmë vetëm marrëveshje deportimi. Është një moment për ta bërë një kapërcim në mentalitet, në trajtimin e këtyre njerëzve. Është gjysma e popullatës andej, kurse ne diskutojmë sa na arrestuan, si do t'i sjellim. Këto janë të gjitha në rregull, por është situatë e vështirë në kuptimin e shtetit shqiptar për ata njerëz, jo vetëm kur ata kanë nevojë të deportohen.

Nuk ka një gjë konkrete që duhet të kërkoj, por sinqerisht duhet ta sensibilizoj, të paktën këtë komision që ne ta çojmë zërin më tej, që të shikojmë legjislacionin apo ndërhyrjen e qeverisë në strukturat shtetërore sa u takon këtyre problematikave. Është gjysma e njerëzve andej, ndërsa ne mblidhemi vetëm për deportime. Ky ishte komenti im dhe patjetër deklaroj mbështetjen time për projektvendimin, por shqetësimi vazhdon e mbetet, mjerisht edhe heshtja e gjithçkaje që përbën shtetin shqiptar në konceptin popullor, por edhe të strukturave. Ne vazhdojmë e heshtim, vazhdojmë e ndjekim këtë rutinën e përditshmërisë dhe problematikat atje ngelen, të paktën të njëjta, por tendenca është edhe të rëndohen.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Çollaku!

E vlerësoj sensibilitetin tuaj lidhur me këtë gjë. Në fakt, ne kemi një nënkomision që merret me diasporën, të cilin e kryeson kolegu Krrashi. Bashkë me kolegun Krrashi kemi diskutuar në më shumë se sa një rast lidhur me propozimet që mund të vijnë në diskutimin e bazës ligjore, të cilën ne tashmë e kemi konsoliduar prej 4 ditësh, edhe për faktin se kemi pasur

Ministrinë e Diasporës, por edhe për faktin se ka agjenci, të cilat adresojnë çështjet e diasporës kudo ku ajo ndodhet në botë.

Po thosha se kam diskutuar me kolegun Krrashi lidhur me përmirësimet që mund të vijnë, qoftë edhe nga ky komision, sigurisht më shumë dritë dhe më shumë prezencë tonën, të të gjithëve ne. Ne mund të organizojmë një takim informal. Mbase mund t'i kërkojmë miqësisht edhe sekretarisë së komisionit që paketën që rregullon kuadrin ligjor, që lidhet me diasporën, të mund të na e risjellë në postën tonë elektronike, në mënyrë që gjithsekush të mund të shikojë se ku mund të ketë vend për të përmirësuar apo për të sjellë në parlament propozimet dhe amendimet tona, madje është në detyrimin tonë dhe në nderin tonë që të mund ta bëjmë këtë gjë. Kështu që unë jam absolutisht jo vetëm e hapur, por është një çështje për të cilën kemi diskutuar shpeshherë dhe kërkoj të falënderoj për sensibilizimin që sjell dhe kërkoj me ngulm që të mund të realizojmë diçka, mbase në fillim të vitit tjetër, ndërkohë mund të kemi idenë se cili është kuadri ligjor dhe ku mund të ketë nevojë dhe mundësi për të përmirësuar, ku mund të ketë nevojë për rritje buxhetimi e kështu me radhë.

Prandaj, thjesht dhe vetëm dua ta risjell, ashtu siç edhe e risolli Kreshniku, ashtu siç edhe e kemi risjellë edhe herë tjetër këtë gjë, të mos mbetet vetëm në nivelin e diskutimit, por ne si komision të mund të marrim disa hapa konkretë, ndaj të falënderoj edhe një herë.

Urdhëron, nënkryetar!

**Tomor Alizoti** – Unë km një sqarim të vogël. Zakonisht europianët, britanikët i ndjekin interesat e tyre në mënyrë brilante dhe vendet si Shqipëria direkt i pranojnë ofertat e tyre.

Në radhë të parë, përveç detyrimeve ndërkombëtare, çfarë fitojmë ne nga kjo marrëveshje, sepse e pashë që edhe ambasada britanike ishte e interesuar për të na sqaruar.

Unë nuk pata mundësi teknikisht të takohesha me ta, sepse dikush që kryen krimin, në konceptin juridik ligjor ka shumë interpretime, mund ta vuajë dënimin edhe në vendin ku ka kryer krimin, pastaj këto janë çështje interpretimesh, prandaj eksitojnë avokatët dhe gjykatat.

Ne si Shqipëria, duke qenë edhe një vend i varfër, për dikë që ka kryer një krim në një vend si Anglia, përse duhet ta pranojmë këtë gjë, përveç detyrimeve ndërkombëtare (po e bëj një anashkalim), pa hyrë dhe pa diskutuar realisht në mënyrë bilaterale me vendin, çfarë përfitojmë ne, sepse ne do të marrim koston, një vend të varfër, ku njerëz që janë të lirë dhe nuk i fitojnë dot 500 euro? Pse duhet ta pranojmë ne këtë, për të kënaqur britanikët?

Mbase isha pak i ashpër, por ne duhet të nisemi gjithmonë, në radhë të parë, nga interesat tona.

Më sqaroni: pse ne duhet të jemi kaq të lumtur që t'i marrim këta njerëzi nga Anglia për t'i mbajtur me kostot e shtetit shqiptar?

**Mimi Kodheli** – Përpara se sa t'ia jap fjalën zëvendësministres apo zotit drejtor, desha t'i them nënkryetarit Alizoti se pyetja është më shumë politike se sa teknike, kështu që zotërinjtë përgjigjen teknikisht nëse ka një përgjigje teknike, pastaj diskutimin politik e bëjmë, pa qenë nevoja që zotërinjtë të jenë këtu.

Zëvendësministri është post politik, por e keni ngritur shumë nivelin e diskutimit, nënkryetar.

**Adea Pirdeni** – Zoti Alizoti,

Kam përshtypjen se, përveç detyrimit ndërkombëtar, interesi i shtetit shqiptar për t'u angazhuar në një marrëveshje të tillë është, në radhë të parë, mbi të gjitha, kujdesi për shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin në Mbretërinë e Bashkuar. Pra, ne nuk marrim përsipër detyrimet ndërkombëtare, nëse edhe ne nuk kemi një interes të shprehur për të mbrojtur të gjithë ata shqiptarë që vuajnë dënimin në këto vende, dhe, mbi të gjitha, për t'u garantuar atyre, (jo vetëm integrimin social, se mund të ngjajë si slogan politik) mundësi për të qenë sa më afër familjeve të tyre këtu në Republikën e Shqipërisë.

Kjo është arsyeja kryesore pse është nënshkruar kjo marrëveshje, gjithashtu edhe fakti se marrëveshja që është aktualisht në fuqi nuk ka prodhuar dot efektet që duhej të kishte për të mundësuar këtë qëllim madhor që ka: mundësimin e vuajtjes së dënimit të këtyre personave në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë takimeve në nivel politik, të përfaqësuara nga Ministria e Drejtësisë, gjatë proceseve kur është nënshkruar marrëveshja në korrik të këtij viti, është kërkuar nga pala shqiptare dhe nga ku është marrë një premtim në nivel politik për t'i asistuar autoritetet shqiptare për të rritur kapacitetet e sistemit penitenciar në Republikën e Shqipërisë, do të thotë që ne nuk mund të marrim përsipër detyrime të cilat nuk arrijmë dot t'i absorbojmë. Pra, është e qartë që çdolloj procesi do të finalizohet vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor, natyrisht edhe në bazë të një analize që bëhet mbi sistemin penitenciar dhe mundësitë e tij për t'i absorbuar këto lloj detyrimesh.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zëvendësministre!



Më shumë se sa shteruese në përgjigjen e fundit, e vlerësoj prezencën tuaj.

Mendoj se kemi diskutuar dhe kemi dhënë përgjigje, për atë që kemi mundur, për të gjithë problematikat që kemi ngritur, kështu që më lejoni ta hedh në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenim.

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenim.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenim.

Miratohet.

Votojmë ligjin në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 2 abstenim.

Miratohet.

Ju falënderoj, të ftuar, për prezencën dhe për përgjigjet!

Kolegë, ju falënderoj shumë për prezencën!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretari**

**Etjen Xhafaj**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**

**Euzheni Pengili**

**Këshilltar i komisionit**

**Genc Pecani**